REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
RRETHI GJYQËSOR FIER

Nr.Regj.them31015-05713-62-2012(2960)(220) Nr.Vendimi 62-2013-724 (324)
Data e Rregjistrimit 18.12.2012/2013 Data e Vendimit 21.02.2013

V E N D I M

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata e Shkalles se Pare, e Rrethit Gjyqesor Fier, e perbere prej:

Gjyqtar: Skënder DAMINI

Asistuar nga **sekretare gjyqesore Elena STRONI**, sot ne Fier me 21.02.2013, shqyrtoi ne seance gjyqesore me dyer te hapura çeshtjen civile Nr. 31015-05713-62-2012 (2960) (220) Rregj.themelt. date 18.12.2012, qe u perket ndergjyqesave:

PALË PADITËSE: Shoqeria "INEL" sh.p.k. Fier, perfaqesuar me autorizim nga av.Rozeta Plaku, anetare e Dhomes se Avokatise Fier, me nr. 252 license dhe NIPT K 2931091 Q.

PALË E PADITUR:

1. Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, perfaqesuar me autorizim nr.243 prot. date 09.01.2013, nga juristi Admir Pahumi.
2. Drejtoria e Apelimit Tatimor prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve Tirane, perfaqesuar me autorizim nr.2406 prot. date 20.02.2013, nga juristi Admir Pahumi.

PERFAQËSUESI I SHTETIT: Avokatura e Shtetit Zyra Vendore Vlore, perfaqesuar nga avokati i shtetit Endri Kotherja.

OBJEKTI:

1. Kostatim i pavleshmerise absolute te aktit administrativ, njoftim vleresimi per detyrimet tatimore nr.10359.7 prot. date 07.11.2012, leshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, lene ne fuqi me vendim nr.24612.3 prot. date 11.12.2012, te Drejtorise se Apelimit Tatimor prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve Tirane.

2. Pezullimin e zbatimit te ketij akti administrativ.

BAZA LIGJORE: Neni 327 i K.Pr.Civile, ligji Nr.9920 dt. 19.05.2008 "Per Procedu *Tatimore ne Republiken e Shqiperise".*

Gjykata, pasi shqyrtoi çeshtjen civile ne prani te paleve, degjoi pretendimet e tyre d pasi e vleresoi çeshtjen ne teresi

VËREN

Pala paditese Shoqeria Tregetare "Inel" SH.P.K. Fier, me padine objekt gjykimi n paleve te paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Fier dhe Drejtorise se Apelimit Tatim prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve Tirane, kerkon nga gjykata konstatimin pavleshmerise absolute te aktit administrativ, njoftim vleresimi per detyrimet tatim nr.10359.7 prot. date 07.11.2012, leshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, l ne fuqi me vendim nr.24612.3 prot. date 11.12.2012, te Drejtorise se Apelimit Tatim prane Drejtorise se Pergjithshme Tirane, si dhe pezullimin e zbatimit te ketij a administrativ.

Pala paditese Shoqeria Tregetare "Inel" SH.P.K. Fier, nepermjet av Rozeta Plaku, seance gjyqesore, pretendoi faktin se me njoftim vlerësimi per detyrimet tatimore 10357/7 prot. date 07/11/2012, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, jane ngarka ne total me detyrimin 5.552.275 Leke, i cili perfshin Gjobe, kamatevonese, interes d detyrim per TVSH për vitet 2009, 2010, 2011, 2012. Pas ankimit të paraqit Drejtoria e Apelimit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë, vendimin nr.24612/3 Prot. datë 11.12.2012, ka vendosur refuzimin e ankimit, p nuk ka paguar detyrimin tatimor te percaktuar ne aktin administrativ detyrimi tatim objekt ankimi.
Bazuar ne kontraten e sherbimit PM-LC-047-04 date 1.09.2004 amenduar me PM-I 047-07 ne daten 17-11-2007, te lidhur ndermjet Shoqerise "SAXON Albania L (Bankers Petroleum Albania LTD), e cila eshte nje shoqeri Kanadeze qe e shtrin fush e veprimtarise se saj ne Zonen Operacionale te Patos-Marinzes Fier per " Operacio Hirdrokarbure", ne vitin 2004, e cila eshte efektive dhe pa ndryshime, qe nga momo i nenshkrimit te saj Shoqeria "INEL" SH.P.K, ne cilesine e nenkontraktorit Shoqerine "SAXON" SH.P.K ka marre persiper kryerje disa sherbime per kontraktor. Per sherbimet e kryera, ato klasifikohen ne shitje te perjashtuara TVSH, bazuar ne ligjin per TVSH i ndryshuar dhe Udhezimin nr.17 date 13.05.2 "Per TVSH"
Sa me siper te gjitha shitjet e kryera nga shoqeria, ne cilesine e nenkontraktorit "Bankers Petroleum Albania LTD" jo vetem qe bejne pjese ne shitjet e perjashtuara TVSH, por edhe kane marre autorizimet dhe vertetimet e nevojshme nga Agje Kombetare e Hidrokarbureve per tu perfshire ne listen e sherbimeve te perjashtu nga TVSH. Pra, sipas pales paditese, ky akt administrativ ne baze te nenit 116 / Kodit te Procedrues Administrative, duhet te konsiderohet absolutisht i pavlefshem arsyet e meposhteme:

1. Ky akt, eshte nxjerre ne kapercim te kompetencave nga Organi Tatimor, pasi vendimi i marre nga ky insitucion, eshte ne shkelje te hapur me dispozitat urdheruese te Ligjit.
2. Gjithashtu, bazuar ne 116/c, ky akt nuk eshte nxjerre ne formen dhe proceduren e kerkuar nga ligji, pasi eshte nje shkelje e paster e ligjit per TVSH-ne. Per pasoje, si akt absolutisht i pavlefshem ai nuk mund te sjelle pasoja e deshiruara per palet. Pra nje Akt administrativ absolutisht i pavlefshëm për shkak të shkeljes thelbësore të ligjit nuk ka fuqinë juridike të një akti të vlefshëm. Ai që në momentin e nxjerrjes së tij nuk krijon dhe as nuk mund të krijojë pasojat juridike, për të cilat është nxjerrë. Një akt i tillë nuk ka fuqi detyruese ndaj personave apo subjekteve, të cilëve u drejtohet dhe, për rrjedhojë, këta ose çdo organ tjetër mund të kundërshtojë drejtpërdrejt plotësimin e detyrimeve apo urdhërimeve që rrjedhin prej tij. Nga natyra e mësipërme e pavlefshmërisë absolute rrjedhin edhe një sërë pasojash të tjera. Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk mund të bëhet i vlefshëm me asnjë veprim të mëvonshëm, qoftë ky edhe pëlqim ose miratim i palëve pjesëmarrëse në të. Perfundimisht, kerkoi nga Gjykata pranimin e padise.

Palet e paditura Drejtoria Rajonale Tatimore Fier dhe Drejtoria e Apelimit Tatimor, prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve Tirane, nepermjet perfaqesuesit me autorizim, juristit Admir Pahumi, u paraqiten vetem ne seancen e fundit gjyqesore date 21.02.2013, duke kerkuar rrezimin e padise.

Avokatura e Shtetit Zyra Vendore Vlore, ne seance gjyqesore, nepermjet avokatit te shtetit, z.Endri Kotherja, ne seance gjyqesore, pretendoi faktin se, *mbi bazën e shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorisë së Kontrollit Tatimor dhe Hetimit Tatimor me nr. 17186 datë 01.08.2012, pika 6 b faqja nr. 2-3:* "Drejtoria Rajonale Tatimore nuk do të njohë Autorizimet apo Vërtetimet për përjashtimin nga T.V.Sh., të lëshuara nga Agjensia Kombëtare e Burimeve Natyrore, në të gjitha ato raste kur Autorizimi apo vërtetimi është lëshuar, pas momentit të kryerjes së shërbimit që i përket fazës së kërkimit të zhvillimit të operacioneve hidrokarbure". Perfundimisht, ai kerkoi rrezimin e padise.

Rrethanat e faktit;

Nga inspektorët e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, është ushtruar kontroll në Shoqeria "INEL" sh.p.k. Fier dhe eshte nxjerre njoftim vlerësimi per detyrimet tatimore nr. 10357/7 prot. date 07/11/2012, i Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, ku eshte ngarkuar ne total me detyrimin 5.552.275 Leke, i cili perfshin Gjobe, kamatevonese, interes dhe detyrim per TVSH për vitet 2009, 2010, 2011, 2012. Pas ankimit të paraqitur, Drejtoria e Apelimit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë, me vendimin nr.24612/3 Prot. datë 11.12.2012, ka vendosur refuzimin e ankimit, pasi nuk ka paguar detyrimin tatimor te percaktuar ne aktin administrativ detyrimi tatimor objekt ankimi.
Në këto kushte, paditësi i është drejtuar gjykatës, duke kërkuar prej saj anullimin e Njoftimeve të Vleresimeve te Detyrimeve Tatimore.

Ligji i Aplikueshëm;

Kodi i Procedurës Civile;

Neni 12
Pala që pretendon një të drejtë, ka detyrim që, në përputhje me ligjin, të provojë faktet mbi të cilët bazon pretendimin e saj.

Neni 16
Gjykata zgjidh mosmarrveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj. Ajo bën cilësimin e fakteve pa u ndikuar nga paditësi. Në gjykim gjykata nuk duhet të luajë rol aktiv".

Neni 32
Padia mund te ngrihet per te kerkuar rivendosjen e nje interesi te ligjshem qe eshte shkelur.

Neni 331
Gjykata, në vendimin e saj përfundimtar, vendos:
- rrëzimin e padisë kur akti administrativ gjendet i drejtë e i bazuar;
- konstatimin e pavlefshmërisë së aktit administrativ;
- anulimin pjesërisht ose tërësisht të aktit administrativ;
- detyrimin e organit përkatës, për të nxjerrë një akt administrativ, në përputhje me ligjin ose për marrjen e masave për rivendosjen e së drejtës së cenuar;
- saktësimin e të drejtave dhe detyrimeve ndërmjet paditësit dhe organit administrativ në marrëdhënien në koflikt, në bazë të ligjit dhe në interpretim të marrëveshjes kur ka të tillë.

Kodi i Procedurave Administrative

Neni 9
Parimi i ligjshmërisë
1. Organet e administratës publike e zhvillojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Marrëveshjet Ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë aderon, ligjet e Republikës së Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave që iu janë dhënë atyre dhe konform qëllimit për të cilin janë dhënë këto kompetenca.
2. Aktet administrative të nxjerra në kushtet e gjëndjes së jashtëzakonshme në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi janë të vlefshme në qoftë se rrezultati i kërkuar në kushtet e gjëndjes së jashtëzakonshme nuk mund të arrihet me mjete të tjera. Palët e dëmtuara nga aktet e lartpërmendura kanë të drejtë të kompensohen për humbjet eventuale në bazë të dispozitave ligjore që rregullojnë përgjegjësinë e administratës publike.

Neni 10
Parimi i mbrojtjes së interesit publik dhe të të drejtave të personave privatë

Administrata publike, në ushtrimin e funksioneve të saj, mbron në çdo rast interesin publik, si dhe të drejtat dhe interesat kushtetuese e ligjore të personave privatë.

Neni 141

Afati kohor per marrjen e vendimit ne nje procedure ankimi

1. Organi administrativ kompetent shqyrton ankimin administrativ dhe del me nje vendim brenda 1-muaji nga data e depozitimit te ankimit.

2. Ne qofte se me kalimin e periudhes se parashikuar ne paragrafin 1 te ketij neni nuk eshte marre asnje vendim ne lidhje me ankimin nga ana e organit administrativ kompetent, pala e interesuar fiton te drejten per t'iu drejtuar gjykates sipas paragrafit te dyte te nenit 328 te Kodit te Procedures Civile.

Ligji Nr.9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", me ndryshimet përkatëse:

Neni 106

Objekti i ankimit administrativ tatimor

1. Tatimpaguesi mund të ankimojë kundër çdo njoftim vlerësimi, çdo vendimi që ndikon në detyrimin e tij tatimor, çdo kërkese për rimbursim ose lehtësim tatimor, ose çdo akti ekzekutiv të posaçëm tatimor, në lidhje me tatimpaguesin.

2. Ankimi bëhet me shkrim dhe në formën e parashikuar në zbatim të këtij ligji, me udhëzim të Ministrit të Financave.

3. Tatimpaguesi e dorëzon ankimin në Drejtorinë e Apelimit Tatimor brenda 30 ditëve kalendarike nga data kur vlerësimi ose vendimi i administratës tatimore është marrë ose vlerësohet të jetë marrë nga tatimpaguesi.

4. Drejtoria e apelimit i dërgon një kopje të ankimit administratës tatimore, që ka nxjerrë vlerësimin tatimor ose vendimin, objekt të ankimit tatimor.

Neni 107

1. Tatimpaguesi, i cili kërkon të ankimojë, sipas pikës 1 të nenit 106 të këtij ligji, duhet që, bashkë me ankesën, të paguajë shumën e plotë të detyrimit tatimor, të përcaktuar në njoftimin e vlerësimit të administratës tatimore.

2. Shuma e pagueshme, sipas pikës 1 të këtij neni, përjashton gjithë gjobat e përfshira në vlerësimin tatimor të ankimuar.

3. Ankimi merret në shqyrtim vetëm kur tatimpaguesi ka paguar detyrimin tatimor, që është subjekt i ankimit.

4. Akti administrativ, i lëshuar nga administrata tatimore dhe për të cilin nuk është ankimuar në rrugë administrative, nuk mund të ankimohet në rrugë gjyqësore."

Neni 108

Kompetenca për shqyrtimin e ankimit tatimor

1. Drejtoria e Apelimit Tatimor shqyrton ankimin tatimor dhe merr vendim në bazë të provave dhe të argumenteve të paraqitura nga tatimpaguesi dhe administrata tatimore.

2. Drejtoria e Apelimit Tatimor ka të drejtë të kërkojë dokumentacion shtesë nga tatimpaguesi ose administrata tatimore.

3. Drejtoria e Apelimit, pas shqyrtimit të ankimit, vendos:
a) lënien në fuqi të aktit, objekt ankimi dhe rrëzimin e ankimit;
b) shfuqizimin/revokimin e aktit, objekt ankimi;
c) ndryshimin e aktit, objekt ankimi, duke e pranuar pjesërisht ankimin.
4. Tatimpaguesi ka të drejtë ta paraqesë personalisht çështjen para drejtorisë së apelimit tatimor ose të caktojë një person për ta përfaqësuar para kësaj drejtorie.
5. Barra e provës, për të vërtetuar se një vlerësim tatimor ose vendim është i pasaktë, bie mbi tatimpaguesin.
6. Vendimi i drejtorisë së apelimit tatimor duhet të përfshijë një shpjegim, me shkrim, për mbështetjen ligjore të vendimit të marrë prej saj, duke përfshirë arsyetimin, në përputhje me dispozitat e nenit 108 të Kodit të Procedurave Administrative.

Pika 8.7 e Udhezimin nr.17 date 13.05.2012 "Per TVSH" ku pershkruhet se operacionet Hidrokarbure dhe shitjet e perjashtuara ne keto operacione.

Neni 8 pika 3 Faturimi dhe Pagesa e kontrates se sherbimit PM-LC-047-04. ku thuhet- *Te gjitha faturat e sherbimeve e kryera nuk duhet te kene te llogaritjen e TVSH pasi ne Baze te Legjislacionit Shqiptar ne Fuqi Kompania dhe Nenkontraktoret e saj jane te perjashtuar nga detryrimi i TVSH per sherbimet e kryera.*
Neni 8 pika 7 Operacionet hidrokarbure Janë të përjashtuara nga TVSH:- Furnizimi i shërbimeve që kryhen nga kontraktorët dhe nënkontraktorët e tyre, të vërtetuar si të tillë nga Agjensia Kombëtare e Hidrokarbureve, lidhur me realizimin e fazave të kërkimit dhetë zhvillimit të operacioneve hidrokarbure ku "Operacionet hidrokarbure", për efekt të këtij paragrafi, ka të njëjtin kuptim si në ligjin nr.7746 datë 28.07.1993 "Për hidrokarburet".Kontraktorët dhe nënkontraktorët që përfitojnë nga përjashtimet e mësipërme janë ato tatimpaguestë TVSH,që kryejnë në emër të tyre vetëm furnizimet specifike të shërbimeve të përmendura në përcaktimet "Kërkim" dhe "Zhvillim", të Ligjit nr 7746 dt 28.07.1993"Për Hidrokarburet".

Vlerësim i gjykatës në këtë proces civil;

Gjykata vlereson se te gjitha shitjet e kryera nga pala paditese, ne cilesine e nenkontrakorit te "Bankers Petroleum Albania LTD", jo vetem qe bejne pjese ne shitjet e perjashtuara nga TVSH, por edhe kane marre autorizimet dhe vertetimet e nevojshme nga Agjensia Kombetare e Hidrokarbureve, per tu perfshire ne listen e sherbimeve te perjashtuara nga TVSH. Pra, ky akt administrative, conform nenit 116/b te K.Pr.Administrative, duhet te konsiderohet absolutisht i pavlefshem. Gjithashtu bazuar ne 116/c, ky akt nuk eshte xjerre ne formen dhe proceduren e kerkuar nga ligji, pasi eshte nje shkelje e paster e ligjit per TVSH-ne. Per pasoje si akt absolutisht i pavlefshem ai nuk mund te sjelle pasoja te deshiruara per palet. Pra, nje akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, për shkak të shkeljes thelbësore të ligjit nuk ka fuqinë juridike të një akti të vlefshëm. Ai, që në momentin e nxjerrjes së tij, nuk krijon dhe as nuk mund të krijojë pasojat juridike për të cilat është nxjerrë.

Ndër parimet e përgjithshme që udhëheqin organet e administrates në veprimtarinë e tyre, janë parimi i ligjshmërisë dhe ai i mbrojtjes së interesit publik dhe të drejtave

të personave privatë, parashikuar respektivisht nga nenet 9 dhe 10 t K.Pr.Administrative.
Parimi i ligjshmërisë kërkon jo vetëm që autoritetet administrative të mos shkeli ligjin, por edhe që të gjitha aktet e nxjerra prej tyre të jenë të autorizuara qartë nga lig dhe përmbajtja e këtyre akteve të jetë në përputhje me atë ligj.
Parimi i sanksionuar në nenin 10 të Kodit të Proçedurave Administrative, realizon nj balancim të drejtë midis interesave publike dhe atyre private, duke qenë të dyja këto t ligjshme.

Në rastin konkret, nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier nuk është respektua parimi i mbrojtjes së interesit publik dhe të të drejtave të personave privatë, si dh parimi i ligjshmërisë që ka të bëjë me respektimin e detyrimeve që parashikohen n nenin 122 të Ligjit Nr.9920 datë 19.5.2008 *"Për Procedurat Tatimore në Republikën Shqipërisë"*, qëllim i të cilit, është mbrojtja në mënyrë reciproke e interesav financiaro- publike dhe të drejtave të personave tatimpagues.

Gjykata, arrin ne konkluzionin se* pala e paditur ne menyre solidare, duhet detyruar per pagimin e shpenzimeve gjyqesore, ku perfshihen taksa e padise ne shumen 12.000 leke, shpenzimet per avokat ne shumen prej 48.000 leke, te njoftimit dhe te shpalljes se vendimit, *me arsyetimin e meposhtem:

Neni 102 K.Pr.Civile, parashikon se: *"Shpenzimet gjyqesore perbehen nga taksat mb aktet, shpenzimet per aktet qe kryhen, si dhe shpenzimet e tjera te nevojshme te gjykimit..."*

Si shpenzime gjykimi, njihen taksat mbi aktet dhe ketu perfshihet taksa qe merret per kerkesepadine, shpenzimet per njoftimin e paleve, te deshmitareve, eksperteve, per kryerjen e ekspertimeve, kqyrjeve ne vend e te tjera te kesaj natyre. Shpenzimet gjyqesore, sipas perberjes se caktuar ne nenin 105, parapaguhen nga pala qe i ka kerkuar ne shumen e caktuar nga gjykata. Me vendimin perfundimtar, gjykata ben rregullimin e pagimit te tyre, sipas nenit 106, i cili shprehet se:

"Taksat mbi aktet, shpenzimet e tjera gjyqesore dhe shperblimi per nje avokat, ne qofte se ka patur te tille, te paguara nga paditesi, i ngarkohen te padituri ne masen e pjeses se padise qe eshte pranuar nga gjykata..."

Masa e shperblimit te avokatit, percaktohet me vendim te perbashket te Ministrit te Drejtesise dhe Keshillit Drejtues te Dhomes Kombetare te Avokatise dhe tarifa ne baze te Urdherit *"Per miratimin e tarifave te shperblimit te avokateve per dhenien e ndihmes juridike"*, per perfaqesimin e çeshtjeve civile ne Gjykaten e Shkalles se Pare, me pale kundershtare, eshte 48.000 (dyzete e tete mije) leke, se bashku me T.V.SH.-ne.

Sa me siper, dolen te qarta nga theniet e paleve, provat shkresore te administruara ne seance gjyqesore.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata konform neneve 126, 306 – 310 te K.Pr.Civile

VENDOSI

Pranimin e padise se pales paditese "INEL" shpk, Fier ndaj pales se paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Fier dhe Drejtoria e Apelimit Tatimor, prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve Tirane.

Konstatimin e pavlefshmerise absolute te Njoftim Vleresimi per Detyrimet Tatimore nr.10359.7 prot. date 07.11.2012, leshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, lene ne fuqi me vendim nr.24612.3 prot. date 11.12.2012, te Drejtorise se Apelimit Tatimor prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve Tirane.

Pezullimin e zbatimit te ketij akti administrative, deri ne marrjen forme te prere te ketij vendimi.

Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palëve te paditura ne menyre solidare.
Kunder vendimit, lejohen ankim ne Gjykaten e Apelit Vlore, brenda 15 diteve, duke filluar ky afat nga e nesermja e shpalljes.

U shpall sot në Fier, datë 21.02.2013.

SEKRETARE
Elena STRONI

GJYQTAR
Skënder DAMINI

Shpenzimet gjyqesore jane:

1. Takse padie	12. 000 leke
2. Takse njoftimi	600 leke
3. Shpenzime avokatie	48 000 leke
4. Takse vendimi	800 leke
Shuma	**61. 400 leke**

VENDIMI KA MARRË FORMË TË PRERË MË DT. 09.03.2013
KANCELARE
ARMELA DIVLJA

KANCELARE
ARMELA DIVLJA

VERTETOHET NJËSIA
NE ORIGJINALIN NE
VOLUM
K/SEKRETARE